Muhamet Pirraku

GJURMË TË VEPRIMTARISË LETRARE SHQIPE ME ALFABET ARAB NË KOSOVË (III)*

1. Krijuesit letrarë të viteve '20-40 të shek. XX

Krijimtaria letrare shqipe me alfabet arab e kësaj periudhe paraqet një vijimësi pa golle të krijimtarisë letrare shqipe me alfabet arab në Kosovë, e zhvilluar nga fundi i shek. XIX deri në vitet '20 të shek. XX.

Mirëpo, vlerat letrare shqipe të kësaj periudhe historike ndryshojnë ani mirë nga vlerat letrare shqipe me alfabet arab të krijuara në periudhën e robërisë osmane. Ajo që këto vlera letrare i dallon më cilësisht nga ato të parat, të hershmet, është tematika e larmishme që trajtuan ato dhe porosia bashkëkohëse e tyre.

Derisa vlerat letrare shqipe të para kësaj kohe kishin për qëllim më parësor iluminizmin në frymë të islamizmit, vlerat letrare të kësaj periudhe paraqitnin një kalim të theksuar nga iluminizmi i penguar, jo i vonuar, në Rilindje jo të vonuar, por të penguar.

Realisht, këtu kemi një vazhdim të letërsisë shqipe të Rilindjes Kombëtare, të cilën, në Kosovë, e ndërpren ngjarjet që pasuan pas Luftërave Ballkanike.

Krijuesit letrarë të kësaj periudhe e përdorën alfabetin arab, jo se ai u pëlqente më shumë për gjuhën shqipe, ose se ata nuk e dinin alfabetin shqip, por, në krye të herave, e përdorën të shtrënguar nga rrethanat politike të kohës. Aso kohe shkrimi i gjuhës shqipe ishte i ndaluar

---

* Pjesa e parë e këtij studimi është botuar në rev. *DITURIA* 1-2, Prishtinë 1978, kurse pjesa e dytë në *GJURMIME ALBANOLOGJIKE — Seria e shkencave filologjike*, Prishtinë IX-1979. Në këtë vazhdim të studimit (III) janë bërë përpjekje për identifikimin e një krijuesi anonim të rrethinës së Vuçitërnës të fillimit të shek. XX. Është hedhur dritë mbi një pjesë të veprimtarisë letrare edhe të poetëve e krijuesve letrarë: Shaip Zurnaxhiut (1884-1951), Faik Efendiut (1900-1943), Hafiz Imerit (1910-1934), Hafiz Imer Shemsiut (1893-1945), e të Mulla Hysein Hysni Statovcit (1900).

Vlerat letrare të këtyre poetëve ndryshojnë ani mirë nga vlerat e krijuesve të periudhave të më hershme, të cilët për gjuhën shqipe përdorën alfabetin arabo-osman. Ky ndryshim qëndron në përmbajtjen e larmishme të temave të trajtuara në poezinë shqipe me alfabet arabo-osman të viteve '20-40. Poezia e kësaj periudhe është poezi e kapërthyer me ide sociale e patriotike e veshur shumë hollë me një petk fetar islam. Realisht, kjo është një poezi e cila paraqet vijimësi në krijimtarinë letrare të Rilindjes Kombëtare Shqiptare jo të vonuar, por të penguar nga robëria e re borgjeze sllave në këto anë.

Poezia e viteve '20-40 të shek. tonë, e zhvilluar në Kosovë, është poezi e angazhuar në shërbim të rezistencës dhe të luftës për liri kombëtare e sociale shqiptare në Kosovë.

rreptësisht me cilindo alfabet qoftë.[1] Bartësitë e kësaj veprimtarie patriotike letrare ishin persona që kishin mbaruar ose mësonin në medresetë bashkëkohëse. Këta krijues letrarë, në pikëpamje politike ishin demokratë antiqeveritarë. Shumë prej tyre ishin edhe anëtarë të organizatave të fshehta kombëtare shqiptare që kishin për qëllim luftën për lirinë e popullit shqiptarë.[2]

Poezia e krijuar në vitet '20-40 është krijimtari letrare e angazhuar. Poenta kryesore e shkrimeve të kësaj periudhe nuk bie në vlerën artistike të saj, por në përmbajtje — për ta mbajtur të gjallë shpirtin shqiptar të masave të trullosura nga shtypja nacionale e sociale e qarqeve borgjeze të huaja.

Rezultatet e deritashme të hulumtimit tonë tregojnë se numri i krijuesve letrarë shqiptarë me alfabet arab, i kësaj periudhe, është i madh. Mirëpo, në këtë fazë të hulumtimit, të cilën ende mund ta quajmë sondim të terrenit, në dorë i kemi një pjesë të vlerave letrare të krijuesve, të cilët, në popull, kanë emër: të Shaip Zurnaxhiut, të Faik Efendiut, të Hafiz Imerit, të Hysein Statovcit e të Vejsel Gutës. Mandej, kemi edhe disa dëshmi për veprimtarinë letrare të Hafiz Islamit, të Sheh Selimit, të Mulla Rifatit, të Hafiz Mustafës e të Sabit Efendiut. E kemi një poezi edhe të një anonimi bashkëkohës i Sheh Malës (1865-1928).

Për prezentimin e këtyre krijuesve dhe të vlerave letrare të tyre, sikur edhe në dy pjesët e para të këtij studimi, kemi ndjekur kronologjinë — kohën kur jetuan dhe vepruan krijuesit, vlerat letrare të të cilëve i kemi në dorë. Besojmë se në këtë mënyrë më qartë do të vihet në spikamë vijimësia në shkrimin e shqipes në rrethana ilegale, në Kosovë, në vitet '20-40 të shekullit tonë.

2. Bashkëkohësi anonim i Sheh Malës

Gjatë punës sonë kërkimore e gjetëm një poezi fetare shqipe me titull: *„Eni vllazni tubohem"*, e cila i kushtohet një personi autoritativ, një humani e dijetari, i quajtur *Hilmi.*

Poezia është ruajtur nga myridë e myhybë melami të Mitrovicës. Është e njohur edhe për qarqet melami e kaderi të Vuçitërnës e të Prishtinës, por edhe në disa mese të dervishëve në Dukagjin. E dinë edhe plejada e hoxhallarëve, të cilët u shkolluan në fillim të shekullit tonë.

---

[1] Shih, *Arkivi i Sekretariatit të Punëve të Jashtme të Jugosllavisë* (DASIP), Fondi *Društvo naroda*, F-15. — Interpelacioni i Hasan Prishtinës Shoqatës së Kombeve, më 15 mars 1927: „(...) Najjasniji dokaz o zlostavljanju albanskih manjina u Državi S.H.S. pruža se činjenicom, da u njoj jedan milion Albanaca postoji bez albanskih škola. Više nego ma koja ova žalba dokazuje, da vlada Države S.H.S. ima za cilj da uništi albanski narod u granicama svoje države. Ako omladina albanskog naroda u Jugoslaviji nema mogućnosti za nastavom u svom maternjem jeziku, onda za njen budućnost postoje samo dve mogućnosti: anacionalizacija ili da se odrekne svakom vaspitanju. Obe eventualnosti jednako su bolne i sudbonosne po budućnost našeg naroda kao što su nedostojne Evrope, u čijim granicama naš narod živi i na čiju najvišu instancu se preko mene svojim za pomaganjem obrača (...)".

Krahaso, Arkivi i Jugosllavisë (AJ) : F-37, K-40/1937. — „Od 1918 godine Arnauti su u Jugoslaviji izloženi ubijanju, paljenju čitavih sela, proganjanju sa zemlje, otimanju kuća, imanja, seoskih ispaša i šuma. Arnautima je zabranjeno upotreba maternjeg jezika, ukištavaju se narodni običaji (...)."

[2] Shih, AJ, 66-57-145/1924; 66-57-145/1925; 66-57-145/1927; 66-57-145/1928; 66-57-145/1935; K-37 K-18/1937

Për thellimin e hulumtimit shkencor është me rëndësi të konstatohet se në qarqet fetare islame të Mitrovicës, poezia *„Eni vllazni tubohem"* konsiderohet vepër letrare e *Sheh Hilmi Maliqit* të Rahovecit. Këta, për një medim të tillë, mbështeten në emrin *Hilmi* që gjendet në shahbejtë të poezisë.[3]

Mirëpo, pas kërkimeve tona në terren dhe pas analizës së dokumentit, kemi konstatuar se poezia *„Eni vllazni tubohem"* nuk është vepër e Sheh Hilmi Maliqit. Kjo mund të hetohet edhe nga porosia e shahbejtës, përkatësisht e strofës së fundit, por edhe nga stili dhe nga gjuha e dokumentit.

Është me rëndësi të vihet në pah se poezia *„Eni vllazni tubohem"* nuk gjendet në *Divan*-in e Sheh Maliqit, e as në dorëshkrimet e tij, të cilat ruhen në Teqenë e Sheh Malës. Atë nuk e dinë për të Sheh Maliqit as trashëgimtarët e Sheh Malës. Ndërkaq, nga myhybë e myridë të Sheh Malës mund të mësohet se shehut të tyre i kanë kushtuar poezi shumë krijues anonim edhe të qarqeve të tjera të dervishëve, por ato poezi nuk jamë mbledhur.

Poezia që e kemi në shqyrtim është e viteve të para të shekullit XX, andaj e botojmë për rëndësinë dokumentare historike me interes për historinë e vargënimit shqip dhe të dijeve të gjuhësisë:

„Eni vllazni tubohem,
n'dhikrat hem na t'him.
Sherbet vahdetit hem pijm,
s'mun e pin ti a s't'kom thon.

Kush t'jen qi e pin sherbetin,
met e t'pa mend hem ecin.
Hakun e ngjohin hem e din,
s'mun e ngjeh ti a s't'kom thon.

Kush e pin hem jet naçar
pej syve gjak hem derdhin,
si bajkush hem ikun
s'mun ik ti'a s't'kom thon.

Gjithsa send hem helaç osht
ftyra e hakit baki osht.
Kto qi shihen hem vet osht,
s'mun e sheh ti a s't'kom thon.

[3] *Shahbejtë* quhet rreshti në ilahi ku shënohet emri i autorit, ose emri i personit që i dedikohet poezia.

Sirri i kyntikenzit osht,
veç dhatit tij vuxhud sḳa.
Vet po flet hem prej Hilmis,
s'mun e ngjeh ti a s't'kom thon.

Sirri i Hilmis sa fija osht
kush e sheh rok inçarin.
Shqip po flet hem pi safis,
s'mun e ngjeh ti a s't'kom thon"[4]



Fig. 1. Poezia e anonimit të Vuçitërnës

[4] Këtë doreshkrim i gjetëm më 10 nëntor 1977 në bibliotekën e A h m e t M i k u l l o v c i t, Mitrovicë — „Lluj Braj 28".

Ahmet Mikullovci ishte dashamir i madh i shkrimit shqip me alfabet arab dhe i shquar për kah ideja përparimtare e kombëtare. Vdiq në vjeshtë të vitit 1978

Tani, shtohet pyetja: Kush ishte autor i poezisë *„Eni vllazni tubohem"?*

Kur të kihen parasysh metri, stili dhe gjuha e autorit, mund të konkludohet se kemi të bëjmë me një krijues me metodë e stil të lapidarsuar prej krijuesit letrar në frymën fetare islame. Ndërtimi i vargut dhe stili sikur flasin se autori i saj i përkiste shkollës letrare të *Sheh Junuzit* (vitet '40 të shek. XIX — 1910).[5] Ndërkaq gjuha e poezisë përkon me gjuhën që flitet në rrethina të Vuçitërnës me shtrirje në Drenicë e Llap. Kjo shihet nga përdorimi i përqendruar i foljeve: *eni, pijm, s'mun, ngjohin (ngjeh), ikun, flet e pi.* Gjuha e kësaj poezie ka disa veçori nga gjuha e poezive të Dervish Salihut (Has), të Sheh Eminit (Gjakovë), të Sheh Hysenit (Prizren) e të Sheh Malës (Rahovec) — krijues letrarë bashkëkohës të autorit të poezisë *„Eni vllazni tubohem"*. Pra, gjuha e poezisë në fjalë nuk është e folme e viseve të Dukagjinit e fillimit të shek. XX.[6]

Dhe, të gjitha këto fakte na japin dorë që autorin e poezisë *„Eni vllazni tubohem"* ta kërkojmë na qarqet dervishe të kaderive të rrethinës së Vuçitërnës, mese këto, ku Sheh Maliqi gëzonte autoritet dhe adhurohej pa masë.

Se autori i poezisë *„Eni vllazni tubohem"* ishte kaderi mbeshtetjen kryesore e gjejmë në vetë poezinë. Thirrja „Eni vllazni...!", përkatësisht thirrja për tubimin e masave mbi baza të përkatësisë së gjakut e prejardhjes etnike, është thirrje karakteristike e kaderive. Kështu, me këtë thirrje, i thirri masat e Hasit të Thatë në kohën e *Lidhjes Shqiptare të Prizrenit* poeti hasjan *Dervish Salihu.*[7] Kështu do t'i thërret ato, masat, edhe poeti prishtinas Faik Efendiu.[8]

Mirëpo, cili mund t'ishte autori i saj?

Rezultatet e hulumtimeve sikur na japin dorë që për autor të kësaj poezie ta kërkojmë njerin prej këtyre dy vuçitërnasve: Sheh Selim Samiun ose Hafiz Mustafën, punëtorë këta arsimorë e krijues në gjuhën shqipe me alfabet arabo-osman.

Dhe, mund të përmbyllim se thellimi i kërkimeve në këtë lëmë — në evidentimin e krijuesve letrarë që shkruan me alfabet arabo-osman, do të hedhë dritë edhe për identifikimin e autorit të poezisë *„Eni vllazni tubohem".*[9]

---

[5] Krahaso. M. P i r r a k u, *Gjurmë të veprimtarisë letrare shqipe me alfabet arab në Kosovë* (II). Gjurmime albanologjike — Seria filologjike — IX (1979).

[6] Krahaso M. P i r r a k u, *Gjurmë të veprimtarisë* (...) I. DITURIA/1978.

[7] Shih po aty, f. 117 *„Eni vllazni ta bajnë dert."*.

[8] Shih në punimin që kemi në duar, te Faik Efendiu. Figuron edhe te krijuesi letrar H y s e i n H y s n i S t a t o v c i. Dervishët kaderi shprehjen *vëllazën* e *vëlla* e kanë fjalë të shtrenjtë. E përdorin në ziqer, në lutje dhe në bisedë.

[9] Në këtë fazë të kërkimeve i kemi në dorë edhe rreth 200 vargje ilahi të autorëve anonim ende të paidentifikuar.

3. Shaip Zurnaxhiu (1884-1951)

Si vazhdues i drejtpërdrejtë, në lëmë të krijimtarisë letrare, i Sheh Malës është Shaip Zurnaxhiu, i lindur në katundin Mamushë të *Drinisë* (Podrime).

Shaip Zurnaxhiu është nxënës dhe myhyb melami i Sheh Hilmi Maliqit. Mirëpo, meqë jetoi dhe veproi pas Sheh Malës, në një kohë, e cila pak a shumë ndryshonte nga koha kur jetoi dhe veproi mësuesi i tij, Sheh Hilmi Maliqi, poezia e Zurnaxhiut është më problematike, më e angazhuar, se e Sheh Malës.

Opusi letrar i Shaip Zurnaxhiut, për kohën kur shkroi, nuk është i vogël. Shkroi në gjuhën shqipe, në gjuhën turke dhe në sllavishte të Rahovecit, kurse për alfabet, për të tri gjuhët, përdori alfabetin arabo-islam.[10]

Mirëpo, gjatë kërkimeve tona në viset e Rahovecit kemi hasur në të dhëna, të cilat flasin se Shaip Zurnaxhiu shkroi edhe me alfabetin shqip, përkatësisht se e ka përdorur edhe alfabetin shqip në punën e tij propagandistike kulturore-arsimore ilegale. Në vitet '30 Shaip Zurnaxhiu ishte person më rëndësi në lëvizjen kombëtare ilegale në Rahovec e rrethinë.

Poezia e Shaip Zurnaxhiut ka rëndësi historiko-dokumentare të kohës kur jetoi dhe veproi autori. Ajo ngërthen probleme sociale, edukative-pedagogjike, patriotike, por edhe tema të dashurisë. Gjuha e poezive shqipe të Zurnaxhiut është gjuhë e viseve të Drinës. Ajo është më e pastër se gjuha letrare e poetit, Sheh Mala.[11]

Shaip Zurnaxhiu, si krijues letrar, duke shkruar në të tri gjuhët që përdorin shqiptarët e Rahovecit, e kreu plotësisht detyrën e urdhërit kombëtar që ia ngarkonte koha.

Poeti Shaip Zurnaxhiu ligjëroi, këshilloi e predikoi në të tri gjuhët, vetëm e vetëm për ta mbajtur të gjallë frymën e përkatësisë shqiptare të masave në Rahovec e rrethinë. Poeti, duke iu drejtuar një të dashure, që me gjasë ishte sinonim për flamurin kombëtar, u shpërmall:

„Due me t'dashtë me zemër plot,
Z'due me dijtë pse derdhi lot,
Due me kajtë un' për gjith mot-
Mu' m'ngushlloi dashnija...".[12]

Duke përfunduar është me rëndësi të vihet në pah se gjatë hulumtimeve tona, në Teqenë e Sheh Maliqit, kemi evidentuar vetëm tri

[10] Sipas të dhënave të mbledhura nga dr. Mark Krasniqi, janë gjetur 17 poezi shqip, 20 turqisht e 5 sllavisht (e folme e Rahovecit) të shkruara nga Shaip Zurnaxhiu. Shih *Gjurmime albanologjike* — Seria e shkencave filologjike III-1973, Prishtinë 1973, 127.

[11] Shih M. K r a s n i q i, *pun. i cit.*, f. 126.

[12] *Po aty*, f. 121.

poezi në gjuhën sllave të Rahovecit, të shkruar prej Shaip Zurnaxhiut. Gjuha e këtyre poezive është me interes për studimin e të folmes sllave të Rahovecit, e cila, sa kemi hetuar, ngritet mbi sintaksën e shqipes.[13]

4. Faik Efendiu (1900-1935)

Njëra ndër fytyrat e ndritshme të kulturës e të arsimit kombëtar shqiptar të viteve '20-30 ishte edhe prishtinasi Faik Maloku, në popull i njohur me emrin *Faik Efendiu.*

Ishte bir i kasapit Rushit Qerim Malokut, i cili në Prishtinë erdhi nga Gjakova. Rushit Qerimi ishte mjaft përparimtar dhe arsimdashës. Ai të birit nuk ia dha zejen e vet, por e dërgoi në shkollë, për ta bërë arsimtar.

Faik Maloku, si nxënës i *Medresesë së Prishtinës,* u dallua në gjeneratën e vet. U shqua posaçërisht me frymën revolucionare kundër padrejtësisë së disa mësimdhënësve ndaj nxënësve të varfër. Kjo bëri që Faiku të bjerë në sy të myderrizit famëmadh Mehmet Efendiut, i njohur në popull me emrin Sheh Mehmet Sezai.

Më 1915, Sheh Mehmeti me bashkëpunëtorin më të ngushtë, *Rexhep Remzi Efendiun,* ikën nga Prishtina, qytet ky që i takonte zonës okupuese bullgare. Ata u vendosën në Mitrovicë, e cila gjendej nën okupimin austro-hungarez. Pushtuesi austro-hungarez në zonën e vet lejoi një sërë lirish kombëtare shqiptare: shkollën shqipe, administratën dygjuhësore me theks në atë shqipe, flamurin kombëtar e liri të tjera.

Sheh Mehmeti me vete mori edhe nxënësin më të zgjuar të Medresesë së Prishtinës, Faik Malokun. Dëshira e Sheh Mehmetit ishte që Faikun ta përgatiste për mësues të shkollës shqipe në Prishtinë. Për këtë qëllim të lartë patriotik Sheh Mehmeti e dërgoi Faik Maslokun në shkollën shqipe të Mitrovicës. Në këtë shkollë ishte mësues luftëtari i shquar për lirinë kombëtare, *Bedri Gjinaj.* Me kërkesë të Sheh Mehmetit mësuesi, Bedri Gjinaj mbajti orë të posaçme për përgatitjen e Faik Malokut për mësues të shkollës shqipe. Për tri vjet sa qëndroi në Mitrovicë, Faik Malokut iu ngulit mirë e thellë dashuria për gjuhën dhe për shkollën shqipe, sa që atyre do t'ua kushtojë edhe jetën.

Pas Luftës së Parë Botërore pushteti serbomadh e mbylli shkollën shqipe të Mitrovicës dhe të tjerat në Kosovë. Prapë u aktivizuan mejtepet e medresetë. Kështu, nxënësit e shkollës shqipe u detyruan që prapë t'i kthehen mejtepit. Kështu u shtrëngua të veproj edhe Faik Maloku. Erdhi në *Medrese të Prishtinës* dhe u diplomua.

Vetëm disa muaj pas diplomimit, më 1921, Faik Maloku, me titullin që cilësoheshin intelektualët — *Efendi,* mori detyrën e pedagogut në *Medrese të Prishtinës.* Punën e mësimdhënësit e filloi nën mbikëqyrjen e

[13] Gjatë punës sonë në Rahovec e rrethinë nuk gjetëm asnjë poezi shqipe të S h a i p Z u r n a x h i u t. Informatorët pohojnë se ato i morën me vete në Turqi pasardhësit e këtij poeti, të cilët atje shkuan në vitet pesëdhjetë.

vazhdueshme e permanente të Sheh Mehmetit, i cilil e çmoi shumë dhe e martoi me të bijën e vet.

Medreseja e Prishtinës ishte e vetmja shkollë e shqiptarëve në Qarkun e Prishtinës (Graçanicës) dhe luante rolin e një si qendër kulturore, e si klub kombëtar. Brenda dyerve të kësaj shkolle zhvillohej një aktivitet i gjallë politik e kulturor shqiptar. Për këtë shkak, organet qeveritare serbomëdha e mbyllën.

Mirëpo, mbyllja e Medresesë së Prishtinës më 1927, shënoi një kthesë në aktivitetin arsimor e kombëtar të Faik Efendiut. Nga kjo kohë nisi puna e pavarur kombëtare e tij. Duke shfrytëzuar lidhjet e baballëkut të vet, të Sheh Mehmet Sezait, me krerët popullor të Llapit, shkoi në Podujevë dhe atje, me ndihmën e fshatarëve e hapi *Medresenë e Podujevës.* Realisht, e barti atje medresenë e Prishtinës, në një mjedis të pastër shqiptar.

Medreseja e Podujevës, e drejtuar prej Faik Efendisë, punoi vetëm dy vjet. Në fakt, Medreseja e Podujevës ishte shkollë kombëtare shqipe, ku ndihej vetëm një frymë e lehtë e fesë. Zëvendësdrejtor dhe mësimdhënës ndihmës i Faik Efendiut ishte nxënësi i klasëve të fundit të Medresesë së Prishtinës, Hysein Hysni Statovci.

Mirëpo, meqë edhe kjo shkollë shqiptare luajti rolin e një qendre kulturore e politike shqiptare, me një organizatë revolucionare patriotike ilegale brenda, pas dy vjetësh të punës e mbyllën organet qeveritare.

Për mbylljen e kësaj shkolle, sa shihet nga një sërë dokumentesh, u angazhuan Shtabi i Komandës Ushtarake të Qarkut të Prishtinës, përkatësisht të Zonës së Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme.[14]

Pas mbylljes së *Mejtepit të Podujevës,* Faik Efendiu një kohë ishte i papunë. Mirëpo, nuk pushonte së punuari në lëmë të diturisë. E përhapte librin shqip ilegalisht. Nëpër katunde të ndryshme të Llapit e Gollakut, në oda, improvizonte shkolla shqipe ilegale. Me 1932 u punësua gjykatës i dytë i gjyqit të sheriatit në Prishtinë. Mirëpo, aktivitetin arsimor e patriotik gjithnjë e më shumë e thellonte. Për këtë shkak dy herë bënë atentat, në të por u shpëtoi pritave, për të vdekur, më 1935, nga TBC-ja.

---

[14] Shih, AJ, Fond *Ministarstvo pravde* Versko odeljenje (Muslimanski otsek 1922-1930-F. 157 *Medresa u Podujevu* orh. oz. X/1927: — „Ministarstvo un. pos. Kralj. S.H.S. — Odeljenji javne bezbednosti Pov. J.B.br. 10226, 10. VI. 1929:

Ministarstvo pravde zahteva od Min. unut. dela: 'da se na rad u privatnoj medresi u Podujevu, treba obratiti pažnje — zatraženo je mišljenje od Velikok župana kosovske oblasti. 'Veliki župan piše: 'Bivša medresa koja je postojala ovde u Prištini u 1927. godini zatvorena je i više nije radila; a kako je sama zgrada bila sklona padu, to je ista porušena. (Medresa është rrëzuar natën nga ana e policisë — M. P.)

'Faik Rušitović, iz Prištine, koji je bio do zatvaranja ove medrese njen direktor (Faiku ishte në skenë, kurse me medrese të Prishtinës udhëheqte Sheh Mehmeti — M.P.), zatražio je dozvolu za otvaranje ovakve privatne medrese u Podujevu, koja mu je i data od strane Min. vere B.M. br. 1 od 3. januara 1927 godine."

Në vazhdim vihet në pah numri i nxënësve dhe shkalla e përgatitjes së tyre. Në medrese vinin 53 nxënës, nga Llapi, Gollaku dhe vise të ndryshme të Kosovës. Një nxënës vinte nga Kumanova. Pjesa më e madhe e nxënësve kishte mbaruar shkollën fillore në gjuhën serbokroate. Pasi kishte folur gjerësisht mbi rreziqet që do të sillnin medresetë shqiptare, përfundonte:

„Sa iznetih razloga mišljenja sam da ovu privatnu medresu u Podujevu trebalo zatvoriti i datu joj dozvolu poništiti, a u buduće ovakvim školama uopšte ne davati dozvole. (...)

Dostavljajući ovaj izveštaj Velikog župana Ministarstvu (e Drejtësisë — M.P.) je čast umoliti, da se ovom pitanju pokloni pažnja; jer policijske vlasti imaju obaveštenja, da su se u ovim školama i tećama spremale pristalice Kosovskog Komiteta, pa su sa tih razloga u Prištini ove ustanove bile i rasturene 1927. godine."

Ministria e Drejtësisë me urdhëresën nr. 13406 b. 125-p të 19. II. 1929 e mbylli medresenë në Podjevë.

Në Prishtinë dhe rrethinë flitet: *„Nazmi Gafurri u vra, kurse Faik Efendiu i coptoi mushknitë për shkollën shqipe. Mësuesi i Nazmiut dhe i Faikut, Sheh Mehmeti, tue ka:jt për kta dy nxânsa të tij, e shterri zanin...!"*

Faik Efendiu sikur t'ishte lindur për mësues i shkollës shqipe. Ngase gjuhës shqipe i kanosej rreziku, posaçërisht në qytet, për moto të veprimtarisë kulturore e politike kombëtare e mbante porosinë: *„Shpiat, odat, xhamiat, teqet e tbanat — bâni shkollë! Shqiptari mundet me jetue shqiptar vetëm me mbajtjen e gjuhës shqipe...!"*

Si plotësim të aktivitetit arsimor kombëtar të Faik Efendiut do konsideruar edhe aktivitetin e tij letrar në gjuhën shqipe. Shkroi ilegalisht, sikur të gjithë krijuesit letrarë bashkëkohës të tij në Kosovë, me alfabet shqip dhe arab. Mirëpo, në shkallën e sotme të hulumtimit i njohim vetëm dy poezi — ilahi shqipe të Faik Efendiut me gjithsej 96 vargje. Faik Efendiu është autor i një kënge qytetare shqipe dhe turqishte, mbi Nazmi Gafurrin.

Poezitë në frymën fetare të Faik Efendiut, që i kemi në dorë, kanë për subjekt luftën kundër përçarjes e seperatizmit si dukuri e përqendruar midis bashkatdhetarëve të tij. Ato janë apel për bashkimin e masave shqiptare rreth një udhëheqësi të respektuar e dinjitar, të drejtë e të dijshëm. Ky bashkim i masave shqiptare në kushte të robërisë borgjeze serbomadhe, kur çfarëdo tubimi jashtë tubimit me petkun fetar ishte i ndaluar, mund të arrihej vetëm me hyrjen në njërin ndër tarikatët në besimin islam. Faik Efendiu, si kaderi, në interes të bashkimit kombëtar të masave, nuk i dha përparësi asnjërit prej tarikateve të përqendruara në Kosovë.

Për ta kuptuar më drejtë poezinë fetare të Faik Efendiut është me rëndësi të vihet në spikamë se ky poet ishte shumë përparimtar dhe shërbimet fetare i kryente në interes të forcimit të ndjenjave kombëtare të masave shqiptare në mesin e tij. Për Faik Efendiun tubimi i masave rreth një kreu të kulturës, në teqe, ose në xhami, ishte formë e aktivitetit kulturor, arsimor e politik kombëtar. Ndryshe nuk mund të veprohej ilegalisht.

Në anën tjetër, duhet të kihet parasysh se në rrethana të robërisë të Jugosllavisë borgjeze, zhveshja e propagandës kombëtare nga elementi fetar islam nuk do të kishte efekt të duhur. Propaganda kombëtare e veshur në petkun fetar përbënte një bllok, një tërësi të shenjtë për ruajtje e mbrojtje me sakrifica mbinjerëzore. Thirrja legale për bashkim, e maskuar me petkun fetar islam, lëvizjes kombëtare për rezistencë i jepte masovitet e kolektivitet legal të shtresave të ndryshme sociale:

„Zoti n'kur'an ka urdhnu
Te ni myrshid për me shku
N'dash ksaj fjale mi besu
Kqyr ajetin 'Vebtegu'.

Tu than Zoti me Kur'an
Bahesh me dreq e shkon për an'
N'xhenet t'Zotit ndash me kan
Lype ni qamil insan.
...

Perendia na ka fal'
Me dit hakun ham m'u fal'
M'u ba arif plot me hall
Sikur gjaja mos m'u nal'."[15]

Duke shfrytëzuar respektin e masave të pashkolluara islame shqiptare ndaj profetit Muhamet, për qëllime të larta politike kombëtare, poeti Faik Efendiu luftoi kundër padrejtësisë, e kundër shtypjes së njeriut ndaj njeriut, dukuri kjo evidente e kohës. U ngrit kundër egoizmit e kapadahillëkut të individëve që kishte për pasojë shthurjen e bashkimit kombëtar të masave:

„Çka s'ja ban ni pun veti
Mos ja ban kerkuj n'gjeti
Kshtu ka than Muhamedi
Plot me zemer hem me ashk
Thuej: Lailahe ilallah
Muhamedyn resulullah!
...

Neve nefsi na huton
Edhe zemrat na i qorron
Ndashi dreqin me perzan
Thoni me zemer hem me ashk:
Lailahe ilallah
Myhamedyn resulullah!"[16]

Kjo që u tha për veprimtarinë arsimore, kulturore e krijuese letrare të Faik Efendiut, e quajmë vetëm një hyrje, një nismë për hulumtimin e veprimtarisë së gjithmbarshme të këtij patrioti. Faik Efendiu, një kohë të gjatë, deri në vdekjen e tij të hershme, ishte sekretar personal i Sheh Mehmet Sezait. Sa kemi mësuar nga kërkimet tona, në këtë fazë të hulumtimit, Faik Efendiu me dorë të vet e qiti në letër pjesën më të madhe të poezive të Sheh Mehmetit. *Divani* i Sheh Mehmetit është në gjuhën turke dhe ruhet në Turqi, te një prishtinas, ish kaderi.

---

[15] Nga ilahia: *„Zoti n'Kur'an ka urdhnu."*
[16] Nga ilahia *„Eni vllazni djal e plak."*

5. Hafiz Islami (1910-1934)

Në fund të viteve '20 dhe në fillim të viteve '30, në fushën e krijimtarisë letrare nisi të shquhet edhe nxënësi i *Medresesë së Gjakovës,* Islam Mehmet Bytyçi, i njohur në popull me emrin e veprimtarisë kulturore-arsimore e letrare *Hafiz Islami.*

U lind në katundin Mllanaviq të Llapushës, rreth vitit 1910, ndërsa vdiq diku në Slloveni, gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak, rreth vitit 1934.

Mësimet Hafiz Islami i mori në mejtepin e vendlindjes, kurse medresenë e mbaroi në Gjakovë te myderrizi i njohur Fahri Efendiu. Një kohë mësimdhënës e kishte edhe Hasan Efendi Nahin.

Në medrese Islam Mehmet Bytyçi, sa dëshmojnë shokët dhe mësimdhënësit e tij, ishte nxënësi më i mirë në gjeneratën e tij. U diplomua në afatin rekord, duke dhënë edhe provimin për titullin fillestar të diturisë — *hafiz.*

Si nxënës, Islam Mehmet Bytyçi, është shquar me dëshirën e madhe ndaj artit letrar. Nisi të merret edhe me krijimtari letrare. Dëshmitë që i kemi në dorë flasin se Hafiz Islami shkroi në gjuhën shqipe dhe në gjuhën turke. Shkrimet e tij kanë frymë laike patriotike dhe janë të shkruara në frymën e *letërsisë popullore historike.* Nga shkrimet e tij shihet se ishte njohës i mirë i gjuhës së mëmës, por edhe i gjuhëve orientale: turqishtes, arabishtes dhe persishtes.

Ishte patriot i pashibla, e fort i dëshiruar në qarqet më të avancuara patriotike të kohës. Mulla Rexhep Krasniqi, Kryetar i *Organizatës ilegale të rinisë përparimtare DRITA* (1937-1941), duke shkruar mbi jetën dhe veprimtarinë arsimore-kulturore të *Mulla Maliq Sylejmanit* (1903-1948), e zuri ngoje edhe Hafiz Islamin:[17]

„Maliq S. Morina e ka pasur shok të pandashëm dhe bashkëpunëtor të palodhshëm Hafiz Islam Mehmet Bytyçin nga fshati Mllanaviq. Ai i ndihmoi shumë Mulla Maliqit në shpërndarjen e librave shqipe në rrethinat e Drinit (...). Ai ka përpiluar edhe vjersha shqipe, por për fat të keq vdiq i ri, prandaj vjershat e tij nuk ekzistojnë, sepse nuk ka pasur kush ia ruan, meqenëse edhe koha ka qenë shumë kritike...".[18]

Gjatë kërkimeve tona në temën: *Shkrimet shqipe me alfabet arab në Kosovë,* në bibliotekën e Mulla Maliq Sylejmanit në Llashkadrenoc, gjetëm disa dokumente me rëndësi për historinë politike dhe kulturore shqiptare.[19] Midis tyre gjetëm një ilahi, të cilën profesor Hasan Efendi Nahi e konsideron për të Haxhi Ymer Lutfi Paçarrizit, një gazelë të poetit të njohur

[17] Për Organizatën *DRITA* gjerësisht M. P I R R A K U, *Aktiviteti i një shoqërie jo të njohur,* „Fjala" 2/1971, *Rilindja* Prishtinë, 6. II-10. II 1974; *Napredni omladinski pokret Kosova 1919-1941,* Zagreb 1976 Fakulteti Filozofik (temë e magjistraturës).

[18] R e x h e p K r a s n i q i, *Të dhëna biografike mbi Maliq Sylejmanin,* Terpezë 1972. Doreshkrimi ruhet në bibliotekë të autorit të këtij punimi, në fondin e Organizatës *DRITA.*

[19] Në bibliotekë të M u l l a M a l i q S y l e j m a n i t më 26 gusht 1973, punuam me F e t i M e h d i u n, Ligjërues i gjuhës arabe në Fak. Fil. të Prishtinës.

Biblioteka e M u l l a M a l i q i t ishte biblioteka më e pasur në pjesën qendrore të Kosovës. Sot janë ruajtur vetëm rreth nëntë metra gjatësi libra me rëndësi për historinë e kulturës islame.

turk, Nijaziut dhe një gazelë, të cilën Mulla Maliq Sylejmani, para vitit 1947, e ka evidentuar për të Hafiz Islamit. Të tri këto poezi janë shkruar me alfabet arabo-osman, por, sa duket, nga persona të ndryshëm.

Gazela, të cilën Mulla Maliq Sylejmani, shok i ngushtë i Hafiz Islamit, e quan për vepër të Hafiz Islamit është poezi patriotike. Poeti e vajton veten, pozitën shoqërore e politike në të cilën e ka hedhur robëria. Kërkon shtegdalje, por kot. Dhe, *O fat i zi më len vetëm pak të qeshi, natë e ditë jam duke derdhur lot!*

Ky është stili i Haxhi Ymer Lutfi Paçarrizit. Kështu shkruante H. Y. L. Paçarrizi. Nëse kjo poezi vërtet është e Hafiz Islamit, atëherë aq më e rëndë del vdekja e hershme e Hafiz Imerit për kulturën shqiptare. Por, një gjë është e qartë: Poezitë dhe mësimet e Haxhi Ymer Lutfi Paçarrizit, të njohura për kah karakteri përparimtar e socialist revolucionar, ishin përqafuar nga qarqet patriotike të rinisë përparimtare të Drinisë e të Drenicës, ku u gjetën këto poezi.

Me interes për studimin tonë është veçanërisht një poezi shqipe, që e gjetëm në bibliotekën e Mulla Maliq Sylejmanit. Poezia është shkruar me alfabet arabo-osman, nga një dorë fort e ushtruar në shkrime letrare.

Pjesa e letrës ku është ruajtur poezia i përket pjesës së dytë të tabakut me formant i rëndomtë. Poezia ka pesë strofa të numëruara me numra arabisht. Mirëpo, strofës së katërt i mungon rreshti i katërt. Duket se këtë rresht e lëshoi papandehur përshkruesi i kësaj poezie, me shumë gjasë Mulla Maliq Sylejmani, i cili poezinë ia dërgoi një bashkëpunëtori të veprimtarisë patriotike ilegale.

Në faqen e anës tjetër të letrës, Mulla Maliqi i shkruante letër një shoku, një miku. Letra është shkruar në gjuhën serbokroate me alfabet qirilik, gjë që kishte për qëllim të largonte interesimin e censurës ndaj përmbajtjes së „dovës turqisht..."

Mirëpo, këta dy rreshta të letrës private tërthorazi hedhin dritë edhe mbi faktin se Mulla Maliq Sylejmani, për aktivitetin arsimor e kulturor ilegal përdori edhe alfabetin shqip. Atij, në këta dy rreshta, iu përvodh germa shqipe *u* për *y* (u-në) qirilicë. Kështu në vend të „...ja ću ti..." i doli „ja ći ti...".

Tani shtrohet pyetja: E cilit krijues letrar është poezia shqipe e gjetur në bibliotekën e Mulla Maliq Sylejmanit?

Meqë poezia nuk ka titull dhe nuk është e nënshkruar, ngase e gjetëm në bibliotekë të Mulla Maliq Sylejmanit, bashkë me një flamur kombëtar të formantit të faculetës, një kohë ishim të mendimit se autor i poezisë në fjalë ishte Mulla Maliqi, i cili është marrë me shkrime në gjuhën shqipe me alfabet shqip, arab e të shifruar për nevoja të Organizatës *DRITA*.

Mirëpo, trashëgimtarët e Mulla Maliqit këtë poezi e ruajnë si shenjë të shokut më intim të babasë së tyre, të Hafiz Islamit të Mllanaviqit, e amanet të babasë për shokun e jetës. Edhe trashëgimtarët e mësuesit të parë të Hafiz Islamit, të bijtë e Mulla Ademit të Mllanaviqit, këtë poezi e

dinë për të kushëririt, Hafiz Islamit. Madje, këtë poezi e quante për vepër të Hafiz Islamit edhe Rexhep Krasniqi, kryetari i *Organizatës DRITA*. Për poezi të Hafiz Islamit e dinë këtë poezi edhe shumë bashkëkohës të Hafiz Islamit.

Ta shohim poezinë më për së afërmi. Poeti me një gjuhë të pastër shqipe, me një letrarishte të Veriut të viteve '20 e '30, të pasuruar edhe me trajta të së folmes së *Drinisë* e të *Llapushës,* duket se i këndonte një dashurie. Mirëpo, puna është më e thellë. Në këtë poezi, na thotë mendja, ka diçka më shumë se dashuria ndaj femrës — kjo është një simbolikë ku këndohet vendlindja, liria, flamuri kombëtar i ndaluar. Ky është komentim i Mulla Rexhep Krasniqit, i cili i dinte përmendësh shumë vargje të kësaj poezie dhe vargje të tjera të ngjashme, të cilat sot dëgjohen si këngë popullore.

Me interes për shkrimin e shqipes është edhe grafia e kësaj poezie. Autori ka bërë një përshtatje të alfabetit arab-osman për gjuhën shqipe. Alfabeti i kësaj poezie e ka germën *rr* të shqipes. Kjo germë është kombinuar me afrimin e dy *R*-ve të arabishtes, ngjashëm me *rr*-në e shqipes të formuar nga afrimi i dy *r*-ve të latinishtes. Mandej autori ka përdorur germën *E* si xhezmë arabe dhe një si *e* fundore arabe. E përdori edhe germën për *I*-në shqipe — një si *n* arabe pa pikë, por në vend të saj një esre vertikale. Mirëpo, autori nuk ka qenë gjithmonë konseguent në përdorimin e zanores *e* midis dy bashkëtingëlloreve në parafjalët *për, në, me* etj.

Ajo që grafinë dhe ortografinë e kësaj poezie e bën më interesante, që nuk hasen në asnjë poezi tjetër të poetëve shqiptarë nga Kosova të cilët shkruan me alfabetin arab-osman, është dyfishimi i zanorës *u* dhe *y* në vend të theksimit të gjatë. Kështu shkroi: *quutet,* për i zgjuar, *fuush, luula, syyn, buukuur, kuulluuet, luum, luulzon,* (të) *luumit* (zot), por edhe *kuur* dhe *tuue.*

Meqë poezinë e kemi si dokument për historinë e vargënimit shqip, e me rëndësi të madhe edhe për studime dialektologjike e gramatikore, e sollëm të transliteruar sa më besnikërisht që ia dolëm:

„N'ty mendoj kuur agon drita
Kuur bylbyli mallshem kendon
N'ty mendoj kuur soset drita
Terri naten kuur e mbulon.
Veçse ty te shoh un anderr
Veçse ty çuutet te kam n'mendim
N'dert(e) (t)'vshtira ti m'je ganderr
Per ty lelehet moj çdo ndeshkim.
Tjera brigje fuusha e zalle
Un t'kam pa larg tuue ba shtreg
E pergjova tjera valle
Me tjera luula syyn ma rrek.

Por ni fuush ma e blert nuk shtrohet
Por ni mal ma i buukur s'rri
Ma i kuulluuet ni luum s'dekohet
.....

N'ty ma i buukuur luulzon prilli
Jan te kanshme stin e mot
N'ty bylbyli pa le dielli
Kendon ma ambel te luumit Zot".[20]

Fig. 2. Poezia e Hafiz Islamit

[20] Dorëshkrimi ruhet në bibliotekën e autorit të këtij punimi, në fondin e Org. *DRITA*.

Nga vargu, stili e simbolika e poezisë së sjellë këtu, shihet se autori i saj kishte metodë pune në krijimtarinë letrare shqipe. Poezia është shkruar nën ndikimin e poezisë së Rilindjes, por më shumë hetohet fryma e poezisë së Mjedës. Mirëpo, fryma popullore në këtë poezi është mjaft dominuese.

Sidoqoftë, kjo dhe poezitë e tjera të ngjashme përkah përmbajtja me këtë, në krijuesit letrarë me alfabet arab të Kosovës të viteve '20-40 bënë ndikim permanent.[21]

6. Hafiz Imer Shemsiu (1893-1945)

Krijuesi letrar me alfabet shqip dhe arabo-osman, Imer Shemsedin Sylejmani, i njohur në popull me emrin *Hafiz Imer Shemsiu,* është poet e këngëtar i dalluar i masave popullore të kohës së tij në Kosovë. Dhe, sikur të ishte zakon që për një person *me vlerë të madhe për historinë* kombëtare të shkruhet me dy fjali, ata që e njohën do të thoshin: Hafiz Imer Shemsiu ishte nervi kryesor i lëvizjes kulturore e arsimore ilegale shqiptare i kohës së tij, në rrethina të Ferizajt, Kaçanikut e të Shtimes. Ishte i njohur, i dashur dhe i respektuar edhe në shumë vise të tjera të Kosovës. Ky është një si Dervish Efendiu i Pejës (shk. XVIII-XIX) për kohën e vet.

Prindërit e Hafiz Imerit erdhën në Kosovë nga viset e Toplicës, pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ndërkaq, Hafiz Imeri u lind në Prishtinë, diku rreth vitit 1893. Në Prishtinë i filloi mësimet fillestare në mejtep. Mirëpo, heret i vdiq babai, e kjo bëri që ta ndërpresë shkollimin. Kujdesin për rritjen e tij e mori daja i tij, Ahmet Efendiu i Sazlisë, dijetar ky i njohur për kohën e tij në gjuhën turke. Ahmet Efendiu e mbajti ngat vetes të nipin dhe e përgatiti për jetë të pavarur. Imer Shemsedini i thelloi mësimet fetare dhe para Ahmet Efendiut e mbrojti provimin për titullin e diturisë *hafiz.*

Në kohën e Luftës së Parë Botërore Hafiz Imeri punoi si nëpunës i Komunës së Talinovcit. Më 1915, me iniciativën e Hasan Prishtinës u hap një shkollë shqipe në Sazli-Talinovc. Përgatitjen kryesore për hapjen e kësaj shkolle e bëri nëpunësi, Hafiz Imeri. Mirëpo, bullgarët e mbyllën këtë shkollë.

Pas Luftës së Parë Botërore Hafiz Imeri i thelloi mësimet edhe në medrese të Prishtinës dhe në atë të Shkupit. Mirëpo, nuk arriti të diplomohet për hoxhë me ixhazet.

Kishte natyrë të hareshme, ishte shumë i zgjuar dhe i gjallë. Pak punonte fizikisht dhe lexonte shumë, kryesisht vepra letrare e historike shqiptare. Si rapsod i njohur e instrumentalist i dalluar me çifteli, iu dha mundësia edhe të shëtitë shumë, e, edhe të njihej e të lidhej me krerë të njohur të lëvizjes kombëtare shqiptare ilegale të kohës. Kah fundi i viteve '20, me ndërmjetësimin e Ahmet Efendiut, u zgjodh imam i Xhamisë së Talinovcit.

[21] Kjo më reflektueshëm shihet nga vargjet e H a f i z I m e r i t dhe të Rizah Strelit, të cilat i sollëm në punimin që kemi në dorë.

Si imam iu krijuan kushte të volitshme për aktivitet patriotik me masat e pashkolluara. Me 1934 Hafiz Imeri e hapi një mejtep në Sazli. Kjo ishte një shkollë shqiptare, e cila vetëm në shikim të parë kishte pamje të shkollës fetare, të mejtepit. Mejtepi i Sazlisë, ku ndihej fjala kryesore e Hafiz Imerit, u bë njëri ndër klubet, i cili vëmendjen kryesore i kushtoi edukimit patriotik të rinisë shkollore.

Hafiz Imer Shemsiu u muar aktivisht me krijimtari letrare. Këtë veprimtari kulturore e ushtroi ilegalisht, sikur edhe krijuesit e tjerë të kohës së tij në Kosovë. Në vitet '20-30 në shkrimet e veta përdori alfabetin arab dhe alfabetin shqip. Alfabetin arab e përdori për poezitë në frymën fetare të cilat kishin karakter të literaturës shkollore. Qëllimi i vetëm i Hafiz Imerit, me këtë krijimtari me petkun fetar islam, ishte të plotësonte nevojat më urgjente të shkollës shqiptare fetare të kohës — të mejtepeve e të medreseve, vende këto, ku fjala shqipe mund të mësohej vetëm nëse me atë trajtohen probleme fetare. Poeti Hafiz Imeri, me ilahitë shqipe ia kishte vënë vetes për detyrë t'i nxirrte ilahitë turqisht e arabisht nga shkolla shqiptare.

Opusi letrar në frymën fetare i Hafiz Imerit është i madh. Sipas të dhënave memoriale të bashkëkohësve të tij, Hafiz Imeri ka shkruar rreth tridhjetë ilahi. Mbështetur në gjatësinë e tri ilahive të këtij poeti të cilat i kemi në dorë, mund të gjykojmë se ilahitë e tij ishin të shkurtëra, mesatarisht me nga rreth 40 vargje. Së këndejmi del se Hafiz Islami shkroi mbi 1000 vargje, e dhënë, e cila përputhet me të dhënat memoriale të bashkëluftëtarëve të Hafiz Imerit në çështjen e shkrimit të gjuhës shqipe.[22]

Poezitë në frymën fetare të Hafiz Imerit janë tematike, të shkruara mbi baza të *Kur'anit.* Shkroi thjeshtë, në gjuhë të popullit, pa shumë filozofime, kuptueshëm, predikuese, porositëse, të lehta për t'i kapur (mësuar). Ato mbanin në vete frymën e melosit popullor shqiptar. Trajtoi tema me tematikë nga pastërtia, nga jeta sociale, mbi drejtësinë, mbi dashurinë vëllazërore e prindore. I këndoi bashkimit kombëtar, u këndoi riteve tradicionale, e riteve të lindjes. Këndoi për vdekjen, namazin, zjaretin e punën.

Shkroi rrjedhshëm, lehtë, qetë, realisht, pa panegjirizëm. Ja rrjedha e vargut të këtij poeti:

„Ani kur t'vjen shpirti per me dal
Sikur vorba kur mer val.
Ani kur t'na qesin n'teneshir
Dot u dokna fort (i) mir.
Ani me bohur do t'na timojn
Me uj t'vokt do t'na pastrojn.

[22] Përpos informatave nga dhjetëra informatore nga viset e Prishtinës, të Ferizajt, të Shtimes e të Drenicës, të dhëna të verifikuara mirë na ka ofruar edhe dr. Liman Rushiti, bashkëpunëtor shkencor i Institutit të Historisë.

Ani me sapun do t'na shkumojn
Me pamuk syt naj qorojn.
Ani me qefin do t'na pshtjellojn
Me tri dizga na shtrengojn.
Ani kater vet do t'na trozojn
Shum xhemati permas shkojn.



Fig. 3. Fragment nga poezia e Hafiz Imer Shemsiut

Ani n'trap te vorit do t'na lshojn
Krejt xhemati amin bajn.
Ani neve n'vor do t'na lshojn
Me shum dhé do t'na ranojn.
Ani dy melajqe na rin n'kam
Do t'na vesin per din e iman.
Ani dy melajqe na rin n'kam
Do t'na vesin per bab e nan.
Ani kur t'vjen shpirti per me dal
Tona azat lypin hallall.
Ani dor e kam do t'na shtrin
Akrabaja (mas) na vin.
Ani hem xhenazen do t'na knojn
Tan xhemati amin bajn.
Ani me shum dhé do t'na rondojn
Tallkinin hoxha do t'na kendon.
Ani tan xhemati n'shpi do t'shkojn
Vetem neve do t'na lon.
Ani udhe mar shok(ë) e dosllar(ë)
Po tutna qi un do t'kaj.
Ani hallah bonma shok e djal
Kto gjynahe qysh i laj.
Ani udha mar shok(ë) e dosllar(ë)
Thuju mue mos tum kajn.
Ani kjo dynja â douran
Lutem zotit ja rahman''.[23]

Ky krijues letrar poezinë fetare e vishte jo vetëm me frymën popullore, por edhe e politizonte deri në shkallën e apelimit, deri në kushtrim. Kjo shihet edhe në ilahinë e cila ishte e lidhur ngusht me kohët e namazit, të lutjeve, ku u apelon bashkatdhetarëve që të kenë kujdes ndaj grackave që ua kurdisnin qarqet qeveritare, të mos shiten e të mos tjetërsohen:

,,Ej i besun bane emrin
Mos ja zin shejtanit venin,
Se e kie mumin emnin.''

Mirëpo, poentën e kërkesave të veta politike e vuri në tre rreshtat e fundit. U ngrit për lirinë e bashkatdhetarëve, e kundër zullumçarëve — *,,Se kurgja nuk po na lan mar''.*[24]

Se në çfarë shkalle e politizonte poezinë e vet fetare, ilahitë, duke u dhënë atyre vulë të poezisë patriotike më bindshëm shihet në ilahinë: *Veduha ajet kur a knu.*

[23] Nga poezia: *,,Ani na ti lutemi perendis.''*
[24] Nga poezia: *,,Gjith sabah ti heret mu qu.''*

Duke u mbështetur, sa për kamuflim të idesë, në ajetin *Veduha* të *Kur'anit,* u ngrit kundër paudhësive e për zbatimin e ligjeve të drejta e humane:

„Sherijat kam ba bejan
Ahir nebi per insan..."

Në vazhdim u muar me çështjen e marrëdhënieve midis popullsisë anase (jerli) e të ardhur (muhaxhire). Marrëdhëniet midis këtyre dy pjesëve të popullit shqiptar në Kosovë, edhe me spica e gracka të huaja, kishin arritur në shkallë të nder, sa që midis anasëve e të ardhurve nuk lidheshin as krushqi. Poeti u angazhua për heqjen e kundërthënieve midis anasve e të ardhurve dhe për bashkimin e tyre vëllazëror në interes të ekzistimit nacional. Bashkimin e këtyre elementeve të popullit e quante urdhër të zotit:

„Hallall bonma ej ymet
Nasihat se kom vasijet
Ni trup me kanen jegvuxhud
Shoqi shoqin mos me dhan
si n'idhnim, qashtu n'gzim
se n'birlik ka gjallnim.
Dorë ka zoti xhemaat
Synet i lashen me namaz:
Muhaxhert hixhret qi kan ba
Jerlis ikram shum me i ba
Hem jerlia qi kan ba gajret
Muhaxherve merhamet
Nermjeveti muhabet
Emer boni ai Muhamet...".[25]

Megjithatë, nga të dhënat memoriale të mbledhura në terren del se ky poet, nuk mbeti në kujtimin e masave popullore me ilahitë fetare, por në saje të krijimtarisë letrare patriotike shqipe me alfabet arab në frymën e melosit popullor dhe me aktivitetin arsimor e kulturor kombëtar ilegal.

Ishte demokrat në fjalë, në vepër e në aksion. Shumë përparimtar, aspak fanatik. Imam i xhamisë po, por edhe liberal në kërkesat e fesë. Krijues letrar në frymën laike patriotike e sociale, artist epik, e tragjik në jetën private familjare.

Meqë, këtu, nuk kemi për qëllim t'i paraqesim edhe vlerat letrare me alfabet shqip të Hafiz Imer Shemsiut, si antipod me ato vlera letrare me alfabet arabo-osman, punë kjo që duhet bërë njëherë tjetër. Në këtë vend le të na lejohet që përmbledhurazi t'i përmendim vetëm ato vepra të Hafiz Imer Shemsiut, të cilat, si të dedikuara për popullin, populli i përvetësoi

[25] Nga poezia: „Veduha ajet kur a knu."
Të tria ilahitë e H a f i z I m e r i t i gjetëm në *Xhaminë e Godancit* (Shtime). Ato janë doreshkrime të nxënësit të Hafiz Imerit, Vehbi Shaqirit nga Vojnoci, të përshkruara në vitin 1942.

dhe i bëri pronë të vetën si vlera epike historike të vetat. Këto janë këngët: *Kanga e Xhemietit* (Bashkimit) në vitet '20. Bënë fjalë mbi organizimin e *Partisë Popullore Shqiptare Bashkimi* më 1920 në krye me Nexhib Dragën. *Kënga e Ahmet Mulla Sylës* të Shtimës i vrarë më 1924, *Kanga e Nazmi Gafurrit* të Prishtinës i vrarë më 1928, *Kanga e Ramë Bllacës* i vrarë më 1937 dhe *Kanga e Banush Sadllarit,* i cili më 1937 u shpëtoi policëve nga dora dhe iku në Shqipëri.

Është me rëndësi shkencore të konstatohet se poemat historike të Hafiz Imerit në masat popullore i shpuri rapsodi meritor *Rizah Streli* (1904-1947)

Kush ishte Rizah Streli?

Njëri ndër bashkëpunëtorët më të ngushtë në veprimtarinë kombëtare ilegale i Hafiz Imerit ishte Rizah Streli. Quhet edhe Rizah Zhegoci. Jetoi në vise të ndryshme të Kosovës, por kohën e pjekurisë e kaloi në vise të Ferizajt, në Dobrevë dhe në Drenicë. Ishte mjeshtër i dalluar drugdhendës dhe instrumentalist i njohur. I binte çiftelisë dhe këndonte më mirë se kushdo i kohës së tij. Ishte patriot i kulluar dhe tërë jetën — si mjeshtër e si këngëtar popullor, e kaloi duke përhapur diturinë shqip, librin shqip. Me një fjalë, pas Vejsel Pagarushës, është pishtari më i shquar i arsimit shqip ilegal në Kosovë. Komponoi këngë lirike e epike dhe i këndoi me çifteli. Atdheu, Kosova, është tema më e trajtuar në opusin letrar të tij.[26]

Realisht, Hafiz Imer Shemsiu dhe Rizah Streli, pas plejadës së Rilindjes, janë pionierë të dalluar të vargënimit shqip laik kombëtar në Kosovë.

Këta dy krijues letrarë të Kosovës në vitet '30 ishin dy zëra që shpërthenin errësirën e dendur në mënyrë të koordinuar, me krijimtari të angazhuar e të planifikuar. Këta dy krijues me poezi ia qanin dertet e hallet njëri tjetrit e të dy bashkë atdheut, Kosovës, si dikur Gurakuqi me Shirokën, të cilët luftonin për gjuhë, për liri e për shkollë shqipe.

Hafiz Imer Shemsiu duke folur për rëndësinë e mësimit të gjuhës shqipe, *të guhës së shpendit,* i drejtohej Rizah Strelit, këngëtarit të shquar, i cili dinte dhe kompononte këngë për të gjithë patriotët që ranë ose që punonin për liri. Patriotët e lirisë Hafiz Imer Shemsiu i quante zotëra:

„O bylbyl sa mir po këndonë
qyr sa fort po ma perget mu,
nat e dit qi po vaitonë,
mu bashku me vllazen tu.

[26] Për R i z a h S t r e l i n shih gjerësisht te H a l i l K a j t a z i, *Një rapsod e poet popullor i panjohur, Rilindja,* Prishtinë 26. IX. 1970. Mendimi i H. Kajtazit se R. S t r e l i është autor i këngës popullore për Ahmet Delinë (Prekaz i Drenicës), del i paqëndrueshëm. Autor i kësaj kënge është D e r v i s h G o x h u l i (Makërmal i Drenicës), autor i këngës për Azem Bejtën

Kije formen hem bukurin;
këndo bylbyl cim cim gjithmonë
se shum emna t'Zotit i dinë,
ti vujtjet t'ona na i diftonë...".[27]

Ndërkaq poeti Rizah Streli në *„Nji përgjegjëje me i falenderime nji Hoxhe vjershtar nga Sazlija, qujtuni Hafuz Ymer Shëmsi, në vitin 1938 me këtë vjershë:*

Qyr Hafuz qi rrin në Sazli,
ti që më konke kombetar,
po gjithnji me rrinë nder sy,
po ban vjersha me do fjal.

Ti e vajtojshe gjithë bylbylin,
me ato kangë qi asht ty kenduë,
se aji i mjeri pe lyp pyllin,
n'tjeter vendë nuk mundë me rrnuë.
.....

T'falem nderes Hafuz i jonë,
gjith rinis i ke ndihmue,
gjith kur folshim per guhë tonë,
fjaltë e tona i ke forcu
.....

Un ket vjershë qi jom tue këndue,
se për ty do fjal po i thomë,
kosovart vyn me kujtuë,
fjaltë e tua se çka jonë
.....

Or Hafuz ti mu me falë,
për këto fjal qi jom tue kenduë,
mbasi digjna tue konë gjallë,
per guhë t'ime me lulzuë.
.....

Ata ket vjersh qi kan me nguë,
Dhe Shqiptar i thjesht me konë,
E din mir se jom pervluë,
Për lirin e gjuhës t'onë".[28]

Këto vargje të poetit Rizah Streli sinjalizojnë shumë për gjerësinë e opusit letrar të Hafiz Imerit. Në shkallën e sotme të gjurmimit, mendojmë

[27] Shih, R i z a h S t r e l i, *Vjersha të paraluftës (1937-1938)*, „PLEJADA" Prishtinë 1971, 130. (I përgatiti për botim H. K a j t a z i).

[28] *Po atv*, f. 125-128. Poezia ka 24 strofa.

se në duart tona kemi vetëm rreth një të gjashtën pjesë të volumit letrar të këtij poeti e iluministi rilindës. Kryesisht na mungojnë poezitë shqipe me alfabet shqip, për të cilat kemi të dhëna se kanë ekzistuar, në të cilat reflektohet lufta për shkollë dhe gjuhë shqipe e Hafiz Imer Shemsiut.

Duke përfunduar për Hafiz Imer Shmsiun, nuk është e tepërt të konstatojmë se këta dy krijues: Hafiz Imeri dhe Rizah Streli ishin si dy kronikë të shquar, të cilët regjistruan në vargje rrahjet e damarit kombëtar të qarqeve patriotike të mesit ku jetuan. Andaj, thellimi i hulumtimit të veprimtarisë së tyre letrare besojmë se do të nxjerrë në dritë vlera të reja poetike e dokumentare letrare të Imer Shemsiut e Rizah Strelit.[29]

Muhamet Pirraku

LES VESTIGES DE L'ACTIVITE LITTERAIRE ALBANAISE A KOSOVË AVEC L'ALPHABET ARABE (III)

Résumé

1-Les créateurs littéraires des années '20-40 du 20-e siècle.

La première partie de cette étude a été publiée á la revue „DITURIA" 1-2, Prishtinë, 1978, tandis que la dernière partie au „Gjurmime albanologjike" /Resherches albanologiques/ — série philologique, Prishtinë, IX-1979.

Cette troisième partie de l'étude fait des efforts pour l'identification d'un créateur anonyme des environs de Vuçitërnë au début du XX-e siècle. Il est aussi éclairé une partie de l'oeuvre littéraire des poètes et des créateurs tels que: Shaip Zurnaxhiu (1884-1951), Faik Efendiu (1900-1934), Hafiz Imeri (1910-1934), Hafiz Imer Shemsiu (1893-1945), et de Mulla Hysein Hysni Statovci (1900).

Les valeurs littéraires de ces poètes se différencient beaucoup des valeurs des créateurs des anciennes périodes qui au lieu de l'albanais utilisaient l'alphabet arabo-osman. Cette différence consiste au contenu diapré des sujets traités à la poésie albanaise des années '20-40 avec l'alphabet arabo-osman. La poésie de cette période est agrippée avec des idées sociales et patriotiques, vêtue un peu d'un habit religieux islamique. En effet, c'est une poésie qui présente une continuation à la création littéraire de la Renaissance Albanaise non tardive, mais gênée par la nouvelle servitude bourgeoise slave de ces endroits.

La poésie des années '20-40 du notre siècle évoluée a Kosovë est une poésie engagée au service de la résistence et de la lutte de libération nationale et sociale des albanais à Kosovë.

[29] Pjesa tjetër e studimit do të botohet si pjesë IV në numrin vijues të kësaj reviste.

Edhe këtu i falenderojmë të gjithë informatorët dhe ata që na ndihmuan në transliterimin e drejtë të vargjeve që i sollëm këtu: Orientalistët R u z h d i S h a b a n i n, profesor në Medresënë *Allaudin* të Prishtinës, F e t i M e h d i u n, ligjërues në Fak. Fil. të Prishtinë dhe M u l l a S h e r i f A h m e t i n, drejtor i Medresesë *Allaudin*.